



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1085/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Mikerem Nishliu, kandidat për anëtar të kuvendit komunal nga radhët e AAK-LDD në Mitrovicë, paraqitur kundër shpalljes së rezultateve përfundimtare nga QNR-KQZ, për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Mikerem Nishliu, kandidat për anëtar të kuvendit komunal nga radhët e AAK-LDD në Mitrovicë ,

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 03.12.2013 në ora 14:53 nga Mikerem Nishliu ku ka pretenduar se iu është bërë gabim gjatë numërimit të votave të tij.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë kopjet e formularëve të rezultateve për kandidat. FRK.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore të kandidatit për anëtar të kuvendit komunal Mikerem Nishliu nuk janë të specifikuara se sa vota i ka pasur dhe sa vota mendon se iu janë vjedhur, FRK si provë nuk është bindëse për shkeljet e pretenduara andaj ankesa vlerësohet si e pa bazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 1085/2013 më datën 06.12.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.